



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 317/6 prot.
2023

Tiranë, më 28. 08.

V E N D I M

Nr. 168, datë 28. 08. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën me nr. 34 regj, datë 02.03.2023, paraqitur nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, kundër Bashkisë Durrës, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “përkatësinë në një grup të veçantë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” (Shoqata), është regjistruar si person juridik/organizatë joqeveritare, me seli në Durrës, nëpërmjet Vendimit nr. 6179, datë 07.03.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Shoqata thekson se në momentin e regjistrimit të saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kanë vendosur si adresë të selisë, shtëpinë e një prej themeluesve të saj. Gjithashtu, në zbatim të ligjit Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, të ndryshuar, ka kërkuar nga ana e Bashkisë Durrës t’i sigurohet një zyrë për të vendosur selinë e saj.

Në kushtet që nga ana e Bashkisë Durrës nuk i është siguruar zyra si mjedis pune, Shoqata i është drejtuar me ankesë me pretendim diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioneri konstatoi diskriminimin e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

Bashkisë Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, ka urdhëruar marrjen e masave për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur të subjektit ankues. Bashkia Durrës, duke mos rënë dakord i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke e kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionerit dhe duke kërkuar shfuqizimin e saj. Në përfundim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vlerësoi të pabazuar kërkesëpadinë e paraqitur dhe vendosi rrëzimin e saj.

Shoqata thekson se Bashkia Durrës, pavarësisht vendimmarrjes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vijon ta diskriminojë duke mos i siguruar një ambient pune.

Në vijim, më datë 16.02.2023, është njoftuar nga ana e Bashkisë Durrës me anë të shkresës Nr. 647, nëpërmjet së cilës i është kërkuar të shlyhet pagesa e taksave dhe detyrimeve vendore për ambientin aktual të punës të deklaruar nga ana e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”.

Sipas subjektit ankues, adresa e kontaktit dhe selia qendrore e saj, është deklaruar fillimisht vetëm për tu rregjistruar si shoqatë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ambientet kanë qenë të marra me qira për një afat 3 muaj. Më pas, selia e deklaruar nuk ka shërbyer më si ambient pune, por është lënë vetëm si adresë kontakti e shoqatës.

Në përfundim, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Bashkisë Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe përkatësinë në një grup të veçantë, si dhe ndreqjen e pasojave të ardhura si rezultat i tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 6179, datë 07.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj të verbër.

Bazuar në ankesën e paraqitur pala ankuese, pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, si person juridik, pasi trajtohet në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme, duke mos e përjashtuar nga pagesa e taksave dhe detyrimeve vendore për ambientin aktual të punës, selinë e saj të deklaruar.

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar për sa kohë që dispozitat ligjore nëpërmjet të cilave Shoqata është përfituese në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk zbatohen nga ana e Bashkisë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet:

“1. Komisioneri ka kompetencë:...b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të

individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;... ”.

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet:

1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se:

“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

““Palë” është:

- a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;*
- b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.*

Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:

- a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;*
- b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative;*
- c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”*

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Komisioneri gjykon se, në adresimin e kësaj problematike kanë interes legjitim të gjitha organizatat apo subjektet përfaqësuese të personave më aftësi të kufizuara në shikim, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre.

Shkaqet e pretenduara nga ankuesi *aftësia e kufizuar dhe përkatësia në një grup të veçantë*, janë shkaqe të mbrojtura nga neni 1, i ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se:

“2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfutuar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;...”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 327/1 prot., datë 10.03.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Bashkisë Durrës, që të jepen parashtime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Durrës, me shkresën³ Nr. 2687/1 prot., datë 23.03.2023, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...kërkesës së Shoqatës për shlyerjen e pagesave e taksave dhe detyrimeve vendore për ambientin aktual të punës të deklaruar nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, nuk mund ti përgjigjemi pozitivisht dhe kjo për mungesë fondesh. Në asnjë rast bashkia nuk i ka premtuar Shoqatës pagesën e vlerës së qirasë në një ambient tjetër, pronë private, të përzgjedhur nga Shoqata...”.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, më datë 01.06.2023 zhvilloi seancën dëgjimore⁴.

Për të sqaruar të gjitha faktet dhe pretendimet e palëve në proces, Komisioneri kërkoi që ditën e seancës dëgjimore të vihet në dispozicion informacioni si më poshtë:

- Informacion dhe dokumentacion provues, nëse i vendos Bashkia Durrës, përpara detyrimit për të shlyer pagesën e taksave dhe detyrimeve vendore, subjektet politike, OJF-të etj., në rastet kur i jep në përdorim ambientet që disponon, për ushtrimin e aktivitetit të tyre?

Seanca u zhvillua me praninë e subjektit ankues, përfaqësuesit të Shoqatës, S. F, si dhe në mungesë të përfaqësuesve të Bashkisë Durrës.

Bashkia Durrës, nëpërmjet shkresës me nr. 2687/3 prot., datë 26.05.2023, dërguan paraprakisht parashtrimet e tyre, duke cituar ndër të tjera, se:

“Shoqata Shpresë për të Verbërit është e regjistruar në sistemin informatik të Drejtorisë së taksave dhe Tarifave Vendore si organizatë jo fitimprurëse në bazë të Paketës Fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 149, datë 22.12.2022. Përsa i përket ndërtesës, kontrata që kanë depozituar në Bashkinë Durrës dhe në zbatim të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për

³ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 327/2 prot., datë 27.03.2023

⁴ Referuar shkresës me nr. 327/3 prot., datë 17.05.2023 të Komisionerit.

organizatat jofitimprurëse”, çdo OJF ka për detyrë që në akt themelimin e saj të përcaktojë ndër të tjera edhe selinë. Po në mbështetje të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Lehtësitë dhe përjashtimet e organizatave jofitimprurëse nga detyrimet tatimore dhe doganore caktohen me ligj. Organizatat jofitimprurëse, pavarësisht nga forma e organizimit, qëllimi që ndjekin dhe veprimtaritë që ushtrojnë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat që realizohen nga dhurimet dhe kuotat e anëtarësisë”. Ky përcaktim nuk përfshin përjashtimin nga taksat dhe tarifave vendore, duke përfshirë këtu edhe taksën e ndërtesës. Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në nenin 22 përcaktohen këto kategori të cilat përjashtohen nga taksat e ndërtesës:

- a) Pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) Banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- f) Ndërtesat e banimit të familjarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse”.

Në asnjë rast vendosja e taksës së ndërtesës për këtë shoqatë nuk përbën rast diskriminimi, por vetëm zbatim të ligjeve tatimore. Sjellim në vëmendjen tuaj që kategoria “të verbër”, si familjarë, janë të përjashtuar nga çdo taksë dhe tarifë vendore dhe kanë zero detyrime në taksat e shtëpisë për të cilat çdo qytetarë i Durrësit paguan 9000 lekë/vit, kjo kategori është e përjashtuar por jo si OJF. Subjektet, qofshin këto njësi tregtare, organizata jofitimprurëse apo familjare që të përjashtohen nga taksta e ndërtesës, duhet të përmbushin një nga kushtet e përcaktuara në nenin 22 të ligjit nr. 9632, të cituar më lart. Kjo ndodh gjithashtu edhe për zërat e tjera të taksave dhe tarifave vendore të cilat gjenden në Paketën Fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 149, datë 22.12.2022 dhe Organizata në fjalë është objekt i shlyerjes së detyrimeve vendore”.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues u njoh lidhur me qëndrimin e mësipërm të Bashkisë. Në vijim, subjekti ankues saktësoi objektin e ankesës duke theksuar se, kërkojnë të mostarifohen nga ana e Bashkisë Durrës për një ambient të cilin nuk e kanë as në posedim dhe as në përdorim që nga viti 2019 kur i ka mbaruar kontrata e qirasë. Sipas Shoqatës, ata i janë drejtuar në mënyrë shkresore Bashkisë Durrës për t'ia bërë me dije një fakt të tillë, pasi janë njohur me detyrimin e pagesës së taksave dhe tarifave vendore, por nuk është marrë në konsideratë. Në këtë kuadër, nga ana e Komisionerit iu kërkua palës ankuese të vërë në dispozicion të shqyrtimit të çështjes një

kopje të shkresës së drejtuar Bashkisë Durrës lidhur me faktin që nuk e kanë as në posedim dhe as në përdorim që nga viti 2019 kur i ka mbaruar kontrata e qirasë, ambientin në fjalë.

Pra, përse u pretendua gjatë seancës dëgjimore, objekti i ankesës për diskriminim nuk lidhej me përjashtimin e Shoqatës nga pagesa e taksave dhe tarifave vendore për selinë e saj, por me faktin që nuk duhet të tarifohen nga ana e Bashkisë Durrës për një ambient të cilin nuk e kanë as në posedim dhe as në përdorim që nga viti 2019 kur i ka mbaruar kontrata e qirasë.

3. Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. 94 prot., datë 07.06.2023, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, vuri në dispozicion të Komisionerit një kopje të kontratës së lidhur me një subjekt privat për selinë e saj dhe një kopje të përgjigjes së kthyer nga ana e Bashkisë Durrës lidhur me detyrimin e saj për pagesën e taksave dhe tarifave vendore. Gjithashtu, parashtroi ndër të tjera se nuk disponojnë kopje të shkresës së drejtuar Bashkisë Durrës lidhur me faktin që nuk duhet të tarifohen prej saj për një ambient të cilin nuk e kanë as në posedim dhe as në përdorim që nga viti 2019 kur i ka mbaruar kontrata e qirasë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i*

dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”*.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a/b dhe 2/c⁵, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;

⁵ Neni 20/1/a/b dhe pika 2/c të ligjit nr. 10221/2010: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi; 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ... c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;...”*

- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfituar të mira apo shërbime dhe më konkretisht në lidhje me faktin që nuk duhet të tarifohet nga Bashkia Durrës për një ambient të cilin nuk e kanë as në posedim dhe as në përdorim që nga viti 2019 kur i ka mbaruar kontrata e qirasë.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Fillimisht në ankesë, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” ka pretenduar se në momentin e rregjistrimit të saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kanë vendosur si adresë të selisë, shtëpinë e një prej themeluesve të saj. Gjithashtu, në zbatim të ligjit Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, të ndryshuar, ka kërkuar nga ana e Bashkisë Durrës t’i sigurohet një zyrë për të vendosur selinë e saj.

Në kushtet që nga ana e Bashkisë Durrës nuk i është siguruar zyra si mjedis pune, Shoqata i është drejtuar me ankesë me pretendim diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioneri konstatoi diskriminimin e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, ka urdhëruar marrjen e masave për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur të subjektit ankues. Bashkia Durrës, duke mos rënë dakord i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke e kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionerit dhe duke kërkuar shfuqizimin e saj. Në përfundim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vlerësoi të pabazuar kërkesëpadinë e paraqitur dhe vendosi rrëzimin e saj.

Në vijim, më datë 16.02.2023, është njoftuar nga ana e Bashkisë Durrës me anë të shkresës Nr. 647, nëpërmjet së cilës i është kërkuar të shlyhet pagesa e taksave dhe detyrimeve vendore për ambientin aktual të punës të deklaruar nga ana e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”.

Sipas subjektit ankues, adresa e kontaktit dhe selia qendrore e saj, është deklaruar fillimisht vetëm për tu rregjistruar si shoqatë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ambientet kanë qenë të marra me qira për një afat 3 muaj. Më pas, selia e deklaruar nuk ka shërbyer më si ambient pune, por është lënë vetëm si adresë kontakti e shoqatës.

Sa më sipër dhe informacionit të dhënë nga ana e përfaqësuesit të Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” gjatë seancës dëgjimore, objekti i ankesës nuk lidhej me faktin përse ata duhet të paguajnë taksat dhe tarifatat vendore si shoqatë, por lidhur me faktin se ata nuk duhet të tarifohen nga Bashkia Durrës për një ambient të cilin nuk e kanë as në posedim dhe as në përdorim që nga viti 2019 kur i ka mbaruar kontrata e qirasë së deklaruar në momentin e regjistrimit në gjykatë. Për këtë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë seancës dëgjimore, kërkoi nga ana e Shoqatës kopje të kërkesave të pretenduara se i ka drejtuar Bashkisë Durrës lidhur me faktin se ata e kanë njoftuar këtë të fundit, se që nga viti 2019, kur ka mbaruar kontrata e qiramarrjes e në vijim

nuk e kanë në përdorim apo posedim ambientin për të cilin i kërkohet të paguajë taksat dhe tarifatat vendore.

Në përgjigje të Komisionerit, Shoqata informoi se nuk disponon shkresa të tilla për shkak të mungesës së ambienteve të punës, si dhe vuri në dispozicion një kopje të shkresës nr. 8381/1 prot., datë 20.10.2022, *“Kthim përgjigje në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore”*. Përmes kësaj shkrese Bashkia Durrës informon Shoqatën Kombëtare *“Shpresë për të Verbërit”* se: *“Shoqata Shpresë për të Verbërit është regjistruar në sistemin informatik të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore si organizatë jofitimprurëse, në bazë të Paketës Fiskale të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 160, datë 23.12.2021. Përsa i përket ndërtesës, kontrata që keni depozituar në Bashkinë Durrës dhe në zbatim të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, çdo OJF ka për detyrë që në akt themelimin e saj të përcaktojë ndër të tjera edhe selinë. Po në mbështetje të këtij ligji “Lehtësitë dhe përjashtimet e organizatave jofitimprurëse nga detyrimet tatimore dhe doganore caktohen me ligj. Organizatat jofitimprurëse, pavarësisht nga forma e organizimit, qëllimi që ndjekin dhe veprimtaritë që ushtrojnë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat që realizohen nga dhurimet dhe kuotat e anëtarësisë”. Ky përcaktim nuk përfshin përjashtim nga taksat dhe tarifatat vendore.”*

Nga përgjigja e Bashkisë Durrës, evidentohet dhe kuptohet që subjekti ankues i është drejtuar këtij institucioni lidhur me përjashtimin nga taksat dhe tarifatat vendore si organizatë në mbrojtje të të drejtave të personave të verbër dhe jo lidhur ankesën objekt shqyrtimi nga Komisioneri, që ka të bëjë me faktin se ata nuk duhet të tarifohen nga Bashkia Durrës për një ambient të cilin nuk e kanë as në posedim dhe as në përdorim që nga viti 2019, kohë kur i ka mbaruar kontrata e qirasë së deklaruar në momentin e regjistrimit në gjykatë.

Për sa më sipër, referuar informacionit të vënë në dispozicion nga ana e Shoqatës Kombëtare *“Shpresë për të Verbërit”*, rezulton se ajo nuk ka aplikuar dhe nuk rezulton se ka kërkuar nga ana e Bashkisë Durrës të mos tarifohen për një ambient të cilin nuk e kanë as në posedim dhe as në përdorim që nga viti 2019, kohë kur i ka mbaruar kontrata e qirasë së deklaruar në momentin e regjistrimit në gjykatë.

Sakaq, Shoqata nuk ka sjellë ndonjë provë a fakt që të vërtetojë faktin se është paraqitur pranë Bashkisë Durrës apo ka kërkuar në rrugë zyrtare të mos tarifohet për ambientin e sipërcituar pasi nuk e ka në përdorim prej vitit 2009.

Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se, pretendimi i subjektit ankues se i është drejtuar Bashkisë Durrës me kërkesë të mos tarifohet për një ambient të cilin nuk e ka as në posedim dhe as në përdorim që nga viti 2019, kohë kur i ka mbaruar kontrata e qirasë së deklaruar në momentin e regjistrimit në gjykatë nuk rezulton i provuar.

Ndër të tjera ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, *“Për organizatat jofitimprurëse”*, i ndyshuar, në Nenin 40 *“Lehtësimi dhe përjashtimi nga detyrimet fiskale”*, parashikon se: *“Organizatat jofitimprurëse, pavarësisht nga format e organizimit, qëllimi që ndjekin dhe veprimtaritë që*

ushtrojnë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, që realizojnë nga dhurimet, grantet, interesat bankarë dhe kuotat e anëtarësisë.

Organizatat jofitimprurëse, që kryejnë veprimtari ekonomike në përputhje me nenin 36 të këtij ligji, i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat, vetëm në rast se të ardhurat e realizuara nuk destinohen për veprimtari, për të cilat organizata është regjistruar”.

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndyshuar, në nenin 22, pika 6 përcaktohen këto kategori të cilat përjashtohen nga taksat e ndërtesës:

- a) Pronat e shtetit dhe të njësisve të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;*
- b) Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;*
- c) Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;*
- ç) Banesat sociale në pronësi të bashkive;*
- d) Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;*
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;*
- e) Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”;*
- f) Ndërtesat e banimit të familjarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;*
- g) Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.”*

Kuadri ligjor mbi taksat vendore në Shqipëri, përcakton të drejtat e detyrimit e njësisve të vetqeverisjes vendore për të aplikuar taksat vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Pra nga analiza e legjislacionit dhe kuadrit ligjor të sipërcituar për organizatat jofitimprurëse nuk parashikohen lehtësira sa i përket përjashtimit nga taksat dhe tarifat vendore. Në këtë kuptim dhe në zbatim të legjislacionit të sipërcituar, Bashkia Durrës ka kërkuar nga ana e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, shqyerjen e detyrimeve vendore në cilësinë e organizatës jofitimprurëse. Gjithashtu, rezultoi se Shoqata nuk arriti të provojë faktin se i është drejtuar Bashkisë Durrës me kërkesë që të mos tarifohet për një ambient të cilin nuk e ka as në posedim dhe as në përdorim që nga viti 2019, kohë kur i ka mbaruar kontrata e qirasë së deklaruar në momentin e regjistrimit në gjykatë. Sakaq, Bashkia Durrës në zbatim të legjislacionit të sipërcituar i është drejtuar Shoqatës me kërkesë për shlyerjen e detyrimeve vendore, duke qenë se nuk ka patur dijeni sa i përket faktit që selia e deklaruar nuk ishte më në përdorim të saj.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e Bashkia Durrës nuk ka ekspozuar ankuesit ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë. Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjektet ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Durrës.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Durrës, për shkaqet e pretenduara në ankesë, atë të aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një grup të veçantë.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” për shkak të aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e Bashkisë Durrës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftëia e kufizuar dhe përkatësia në një grup të veçantë)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)